



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: Redaktimi në media

<i>Pedagogu:</i>	Prof. asoc. dr. Bashkim GJERGJI
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 2 seminar në javë x 3 grupe) 36 ushtrime
<i>Lloji i lëndës:</i>	detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Lëndë praktike, që fokusohet në përmirësimin cilësor të përmbajtjes mediatike, që publikohet, apo transmetohet. Studentët mësojnë për “kalendarin” e punës konkrete me shkrimin, duke startuar me përcaktimin e temës, titullit, këndit dhe çdo hallkë tjetër të procesit krijues si dhe për nevojën e rishikimit dhe rishkrimit për shmangien e dobësive, mangësive në aspektin e standardeve mediatike (burimet, datat, emrat, qartësia e paragrafit apo e krejt materialit, ruajtja e kohezionit të script-it, respektimi i zhanrit, respektimi i standardit gjuhësor, kujdesi për linjën e përgjithshme etike të mediumit, kujdesi për termat, fjalën, diçitura dhe formulimi i titujve).

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Objekti, përmbajtja, detyrat dhe rëndësia e kursit.
2. Redaktimi – kur dhe pse? Flitet për nevojën e ndërhyrjeve kur shkrimi i mungojnë të dhënat kyç si burimet, koha dhe vendi, kur ka mangësi në atribumim. Flitet për nevojën e përmirësimit të materialit bazë përmes latimit të frazës dhe e gjithë kjo ekspozohet përmes shembujve mediatikë.
3. Struktura e shkrimit, dallimi mes temës dhe titullit, rëndësia e okielos dhe e nëntitullit, kujdesi për përsëritjet, nevoja e përsëritjes së atyre detajeve individuale apo të situatës që theksojnë idenë bazë.
4. Titulli si esencë e shkrimit. Praktikohet dhënia e një numri të konsiderueshëm titujsh, që evidentojnë qartë objektin. Studentët ftohen të bëjnë ndryshime duke dhënë versionet e tyre dhe duke i shpjeguar ato në auditor.
5. Fjalja dhe fragmenti i fjalisë. Theksohet rëndësia e fjalës shqip, duke eliminuar huazimet e panevojshme. Struktura e fjalisë sipas rregullave drejtshkrimore dhe fragmentimi i fjalisë në rastet kur autorët përfshijnë çështje a ide në një fjali të vetme.
6. Paragrafi, sa rreshta zakonisht, si duhet shkruar, si duhet të jetë në raport me paragrafet paraardhes e pasardhes. Studentët shkruajnë, këmbëjnë mes tyre paragrafët e shkruar dhe presin mendimin e kolegëve.
7. Rishikimi i plotë dhe ai i pjesshëm. Rishikimi i plotë dhe bashkëpunimi me autorin, ku nis dhe përfundon puna e gazetarit që redakton, ruajtja e stilit të autorit.
8. Përpunimi i diçiturës së fotos, teksti i reklamës, vendi dhe rishikimi i shënimit të grafikës në përputhje me tekstin shoqëruar të vetë gazetarit apo autorëve të ndryshëm.
9. Struktura e lajmit (I). Praktikohen shkrime lajmesh me krerë të drejtpërdrejtë, më pas të tërthortë, me përshkrim, humor etj. Informi i i ngjarjeve soft e atyre hard
10. Struktura e lajmit (II). Vazhdon puna me lajmin si gjini e rëndësishme e shkrimit mediatik që edukon ekonomizimin e fjalëve, frazave, tekste të ngjeshura, të qarta dhe të sakta. Studentë paraqesin prurjet e tyre nga terreni i kërkimit të lajmit dhe shkruajnë versionet e tyre.

11. Shkrimi për radio dhe televizion. Praktikohen shkrimet e shkurtëra të ripaa, të redaktuara në bazë kriteresh: informim i qartë e i plotë dhe respektim i minutazhit në dispozicion.
12. Teknologjitë e reja, mediat e reja dhe shkrimi për to. Praktikohet shkrimi i shkurtër me karakteret e kërkuara, jepen modele shkrimesh në rrjetet e ndryshme dhe analizohen nga pikëpamja e standardeve profesionale duke theksuar vendet ku duhet ndërhyrë.
13. Modeli i Twitter dhe qytetarët – gazetarë. Ofrohen modele të të dy linjave dhe ftohen studentët që të përgatisin modelet e tyre individuale për publikim, që më pas u nënshtrohen analizave përkatëse.
14. Redaktim Zhanresh – si të veprojmë mbi intervistën, reportazhin, përshkrimin. Ruajtja e dialektalizmave kur shërbejnë për tipizim individësh.
15. Nevoja për rilexim. Theksohet ideja e “pauzës emocionale” dhe studentët praktikojnë rileximin e materialeve që kanë përgatitur për botim a transmetim.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në:100% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Ushtrime për botim a transmetim: format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	90% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

- 1.F.Baskette/J. Sissor/ B.Brooks, The art of editing, 1997
2. S.Russ Mhol, Gazetaria, K&B, 2010

Literatura plotësuese:

Rekomandohen për t'u lexuar si modele shkrimesh, krahas materialeve të përditëshme të publikuara në gazeta e revista, edhe:

1. Th. Friedman, Bota në kohë të terrorizmit, Instituti i Dialogut&Komunikimit
2. Roberto Saviano, Gomorra, Dudaj 2008